



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISHTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR.nr.27/24

AUTORITETI KOMPETENT I GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË - Kryetarja e Gjykatës Albina Shabani Rama, duke vendosur sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga av. F.N ndaj gjyqtarit N.N, bazuar në dispozitën e nenit 9, paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, me datë 27.11.2024 merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa disiplinore e ushtruar nga av. F.N ndaj gjyqtarit N.N, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Me datë 19.11.2024 Kryetarja e Gjykatës ka pranuar ankesën disiplinore të parashtruar nga av. F.N ndaj gjyqtarit N.N, me arsyetimin se gjyqtari përkatës me datë 28.06.2024 me aktvendim të posaçëm në lëndët C.nr.1678/23 dhe C.nr.1675/23 i ka ftuar paditësit-përfaqësuesit me autorizim që të bëjnë precizimin e padisë, ashtu edhe siç kemi vepruar me parashtrësën e datës 11.07.2024, duke bërë precizimin sipas udhëzimeve të gjykatës sa i përket objektit të padisë dhe caktimit të lartësisë së kërkesëpadisë, ndërsa sa i përket precizimit subjektiv-caktimit të subjektit juridik, i njëjti ka qenë i precizuar në pasi, mirëpo përkundër kësaj gjykata këto lëndë me aktvendim të veçantë i ka hedhur poshtë duke konstatuar se paditësit nuk kanë interes për të vazhduar me këtë çështje kontestimore, ndonëse në parashtrësë por edhe pasi ishte caktuar pala e paditur sipas kontratës së punës. Tutje parashtruesi i ankesës ka deklaruar se ka ushtruar ankesë ndaj këtyre dy aktvendimeve, ndërsa gjykata në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ për unifikimin e taksave gjyqësore, me aktvendim të posaçëm e ka detyruar paditësin për pagesën e taksës, duke i paralajmëruar për ekzekutim të dhunshëm të taksës, edhe përkundër faktit se sipas udhëzimit kjo formë e detyrimit nuk është e përcaktuar, pasi që për mos pagesën e taksës janë të përcaktuara vetëm pasoja procedurale.

Përveç kësaj, sipas parashtruesit të ankesës me datë 23.09.2024 nga i njëjti gjyqtar ka pranuar aktvendimin C.nr.1621/23 të datës 18.09.2024 me të cilin aktvendim është konstatuar e tërhequr padia me arsyetimin se “ është tërhequr padia e paditëses F.B-K, kundër të paditurës Qendra e Mjekësisë Familjare Podujevë, lidhur me kompensimin e pagës së 13-të, me arsyetimin se me aktvendimin C.nr.1621/23 të datës 28.06.2024 është ftuar i autorizuari i

paditëses av. F.N që të bëjë rregullimin e padisë dhe atë të bëjë plotësimin e padisë për të paditurin, por nga shkresat e lëndës shihet se të njëjtin aktvendim paditësi- i autorizuar i tij e ka pranuar me datë 05.07.2024, siç vërtetohet nga fletëkthesa në shkresat e lëndës, andaj gjykata në kuptim të dispozitës të nenit 102.3 e konsideroi të tërhequr padinë”. Sipas parashtruesit të ankesës, si përfaqësues i autorizuar i paditëses në lëndën me shenjë C.nr.1621/24 nuk ka pranuar aktvendimin për precizim – plotësim të padisë, në rastin konkret aktvendimin C.nr.1621/23 të datës 18.09.2024, fakt ky të cilin gjykata e shkallës së dytë mund të konstatoj lehtë, pas analizimit të shkresave të lëndës dhe provave të bashkangjitura me këtë ankesë dhe veprimeve procedurale të gjykatës.

Sipas tij, me të pranuar aktvendimin C.nr.1621/23 të datës 18.09.2024 (aktvendimin e ankimuar), me të cilin aktvendim është konstatuar se është tërhequr padia, janë analizuar shkresat e lëndës dhe është konstatuar se në plikon e dërguar dhe të pranuar me datë 05.07.2024, e cila është e vetmja pliko e pranuar nga Posta e Kosovës gjatë kësaj periudhe¹, janë shënuar shenjat e lëndëve C.nr.1621/23, C.nr.1675/23, C.nr.1739/23 dhe C.nr.1803/23, ndërsa në këtë pliko kanë qenë të vendosura vetëm dy aktvendime, atë me nr. C.nr.1675/23 dhe C.nr.1678/23, ndërsa kanë munguar aktvendimet e tjera(lëndët me shenjë C.nr.1739/23 dhe C.nr.1803/23 nuk kanë qenë fare lëndë të cilat janë përfaqësuar nga i njëjti).

Ndër të tjera ka deklaruar se nga kjo që u tha më lartë vërtetohet pa mëdyshje fakti se si përfaqësues të paditëses nuk kanë pranuar aktvendimin C.nr.1621/23 të datës 28.06.2024 siç pretendon gjyqtari, por sipas tij këto veprime të gjyqtarit janë të qëllimta dhe subjektive e që kanë të bëjnë personalisht me të si përfaqësues i autorizuar, me qëllim që të pengohet në ushtrimin e profesionit të avokatisë. Sipas tij fakti se i njëjti ka vepruar në këtë formë duke qenë subjektiv, mund të vërtetohet edhe nga praktika e tij si gjyqtar, këtë pretendim e ka mbështetur edhe në faktin se me datën 30.09.2024 është paraqitur në Gjykatën e Podujevës me të vetmi qëllim që ta kuptoj nëse ky rast ka të bëjë me ndonjë gabim teknik dhe ti sqaroj të njëjtit se nuk ka pranuar aktvendimin në fjalë, e gjithashtu të sqarohet me arsyet se pse po hedhen paditë të cilat i njëjti i përfaqëson, edhe pse të njëjtat janë të precizuara në kuptimin subjektiv(sipas kontratës së punës) ku edhe ka kërkuar takim me gjyqtarit ku nga recepsioni është njoftuar se gjyqtari është i nxënë dhe duhet të presë, ku edhe pret deri në ora 14:30, ku më pas përmes recepsionit gjyqtari njoftohet se është av. F.N që ka kërkuar takim, i njëjti refuzon takimin edhe përkundër faktit se në mëngjes kishte pranuar të takohet por kishte kërkuar që të pres me arsyetimin e agjendës së tij.

Në fund ka deklaruar se konsideron se gjyqtari ka qenë subjektiv dhe për arsye krejtësisht personale me të si përfaqësues me autorizim ka vepruar në këtë formë, me qëllim të krijimit të pasojave procedurale, dhe kështu u janë shkelur klientëve të tij të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 21 dhe 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në ndërlidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ka kërkuar që pas analizimit të të gjitha rrethanave të konstatohen shkeljet e subjektivitetit dhe të shqiptohet masë adekuate.

¹ Në ankesë është bashkangjitur komunikimi i parashtruesit të ankesës me zyrtarët përkatës të Postës së Kosovës.

Me datë 20.11.2024, Kryetarja e Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 paragrafi 5 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga av. F.N ndaj gjyqtarit N.N.

Gjyqtari N.N në deklaratën e tij të dhënë me shkrim në lidhje me pretendimet e parashtruesit të ankesës ka deklaruar se pretendimet janë në tërësi deklarime të pabazuara dhe pa mbështetje ligjore, ngase gjatë gjithë kohës kujdeset që vendimet e tij të jenë në përputhje me dispozitat ligjore, e jo sipas vullnetit dhe dëshirës së palëve, për më tepër si në arsyet e dhëna në aktvendimet e cituara, si dhe veprimet e tjera që janë ndërmarrë që gjenden në shkresat e lëndës.

Sipas tij, me rastin e vendosjes qëllimi i tij i vetëm si gjyqtar ka qenë dhe mbetet nxjerrja e një vendimi të mbështetur në prova dhe të bazuar në dispozita ligjore, duke u kujdesur që askujt të mos i mohohet e drejta e tij por as mos ti pranohet një e drejtë, e cila nuk gjenë mbështetje në prova dhe nuk është e bazuar në dispozitat ligjore.

Lidhur me pretendimin e palës ankuese se i është kërkuar nga recepsioni që të pres për shkak se gjyqtari është i zënë dhe se i njëjti ka pritur, gjyqtari ka deklaruar se kjo aspak nuk qëndron pasi që si gjyqtar jo vetëm në këtë rast por në asnjë rast dhe me asnjë avokat tjetër kushdo qoftë ai nuk cakton termin për takim a po konsultim, për një çështje konkrete dhe asnjëherë nuk kontakton direkt me asnjë avokat apo palë për cilëndo çështje të ngritur para gjykatës. Sipas tij, në çdo rast kur një palë a po avokat cilido qoftë lajmërohet në receptionin e gjykatës me kërkesë për të kontaktuar me gjyqtarin, nga të njëjtit kërkohet që për të gjitha kërkesat a po çështjet të cilat ata i kanë t'ia paraqesin gjykatës me shkrim dhe të njëjtat do të shqyrtohen nga gjykata.

Tutje ka deklaruar se kështu është vepruar edhe me rastin e këtij palës ankuese, i cili ka qenë në gjykatë me datë 30.09.2024 diku rreth orës 13:45 me ç 'rast është kërkuar nga i njëjti që për çfarëdo kërkesë, ankesë a po çka do qoftë ajo, gjykatës t'ia paraqes me shkrim dhe gjykata do ta shqyrtoj atë. Mirëpo sipas gjyqtarit, i njëjti me këtë rast duke qenë se nuk është pranuar në takim, ka deklaruar se "më mirë i bie me më pranë në takim se sa me inicë masa disiplinore".

Lidhur me pretendimin tjetër të palës ankuese se konsideron se gjyqtari ka qenë subjektiv dhe për arsye krejt personale me të, e me qëllim të krijimit të pasojave procedurale ka vepruar në këtë mënyrë, sipas gjyqtarit ky pretendim është absolut i paqëndrueshëm, ngase sipas tij me të njëjtin nuk është njohur kurrë më parë asnjëherë personalisht, as me palët të cilat i përfaqëson. Prandaj, tutje ka deklaruar se nuk mund ta imagjinoj se si ka mundur të ketë diçka subjektive personale me të, e për pasojë të kësaj të ketë qëllim që të shkaktoj pasojat procedurale, kur me të njëjtin sipas tij nuk është njohur kurrë më parë as personalisht as nga puna e përditshme në gjykatës.

Në fund ka deklaruar se nga arsyet e lartëcekura më lartë dhe me përgjegjësi të plotë konsideroj se nuk qëndrojnë pretendimet e ngritura nga pala ankuese dhe si të tilla nuk kanë mbështetje në asnjë provë çfarëdo qoftë ajo dhe nuk gjejnë mbështetje në dispozitat ligjore dhe si e tillë duhet të refuzohet si e pabazuar.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe deklaratës së gjyqtarës ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit N.N.

Për gjykatën nuk është kontestuese se gjyqtari N.N me datë 18.09.2024 ka nxjerrë Aktvendimin C.nr.1671/23 sipas të cilit ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit F.B, me arsyetimin se “me aktvendimin e datës 28.06.2024 ka ftuar paditësin që ta bëjë rregullimin e padisë dhe atë: *“të bëjë plotësimin e padisë për të paditurin (emërtimin e personit juridik), të bëjnë rregullimin e petitumit të padisë duke e përcaktuar qartë kërkesëpadinë me të cilën do të saktësojë shumën e kërkuar për secilën kërkesë, të përcaktojë vlerën e kontestit, t’i dorëzojë provat të cekura në padi dhe provat tjera eventuale të cilat disponon për vërtetimin e fakteve, dhe Autorizimin e rregullt për përfaqësim, ku nga shkresat e lëndës shihet se të njëjtin aktvendim paditësi-i autorizuari i tij e ka pranuar më dt.05.07.2024, siç vërtetohet nga fletëkthesa në shkresat e lëndës, mirëpo pasi që paditësi në afatin e caktuar nga gjykata e deri më momentin e nxjerrjes së këtij aktvendimi, nuk e ka paraqitur padinë e përmirësuar-plotësuar në aspektin subjektiv dhe objektiv siç ka qenë i detyruar me aktvendimi e cituar, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të dispozitave të nenit 102.3”.*

Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të ankesës se i njëjti nuk e ka pranuar asnjëherë këtë aktvendim dhe se gjyqtari ka bërë gabim teknik me procedimin e dërgimit të këtij vendimi, ku sipas tij në zarfin e dërguar me datë 05.07.2024 në plikon e zarfit ka shënuar numrin e lëndës C.nr.1621/23 por në fakt nuk e ka bashkangjitur fare Aktvendimin, për Autoritetin Kompetent është e pakuptueshme se si nga muaji Korrik 2024 kur parashtruesi i ankesës ka rënë në dijeni për një situatë të tillë nuk ka kërkuar nga gjykata përmirësimin e një gabimi të tillë teknik, duke qenë në dijeni se krijimi i një situatë të tillë sjellë deri tek pasojat procedurale, që për nga mundësia një gabim i tillë teknik edhe mund të ndodhë për shkak të numrit të madh të lëndëve me të cilat gjyqtarët janë të ngarkuar, por që legjislacioni në fuqi ka lejuar mundësinë e korrigjimit të të gjitha vendimeve a po situatave të krijuara kur korrigjimet kërkohen brenda afateve të përcaktuara kohore.

Në rastin konkret, nga muaji Korrik e deri në muajin Shtator kur është nxjerrë aktvendimi për tërheqje, parashtruesi i ankesë ka pasur në dispozicion tre(3) muaj që të kërkojë nga gjykata përmirësimin e një gabimi të tillë nëse i njëjti vërtetë ka ndodhur, pasi që vetëm nga kjo deklaratë është vështirë të provohet nëse me të vërtetë në atë pliko ka qenë a po jo Aktvendimi C.nr.1621/23 i datës 05.07.2024.

Sa i përket pretendimit se gjyqtari i çështjes nuk e ka pranuar në takim parashtruesin e ankesës i cili ka pasur për qëllim ta njoftoj gjyqtarin për një gabim të tillë, Autoriteti Kompetent njofton parashtruesin e ankesës se komunikimi ex-parte është tërësisht i palejuar dhe gjyqtari duhet të jetë gjithmonë i vëmendshëm që ti shmangët një situatë të tillë.

Gjyqtari i çështjes me të drejtë e ka udhëzuar përfaqësuesin e paditësit – këtu parashtruesin e ankesës se në lidhje me çfarëdo ankese të drejtohet me shkrim, sepse në fakt kjo është e vetmja mënyrë e lejuar e komunikimit të palëve me gjyqtarin, sepse procesi i duhur gjyqësor kërkon që të gjitha palët dhe përfaqësuesit e tyre të jenë pranues të çdo komunikimi që bëhet me gjyqtarin.

Kontaktet ex-parte, qofshin të paqëllimshëm apo të qëllimshëm, kanë ndikim serioz tek besimi i palës në procedurë si dhe tek publiku në kuptimin nëse vendimi i gjyqtarit bëhet në bazë të komunikimit privat me gjyqtarin, apo nëse vendimi po merret ashtu siç duhet, në bazë të meritave të rastit.

Kryetarja e Gjykatës gjeti se pretendimet e paraqitura nga përfaqësuesi i paditësit – këtu parashtruesi i ankesës, janë pretendime që kanë të bëjnë me veprime procedurale të ndërmarra nga gjyqtari e që nuk parashihen si rrethana konkrete për të cilat mund të iniciohet procedurë disiplinore sipas nenit 5 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Mënyra e vendosjes lidhur me propozimet e palëve në procedurë, janë në kompetencë ekskluzive të gjyqtarit të çështjes dhe si të tilla nuk mund të komentohen nga Kryetarja e Gjykatës, mirëpo legjislacioni në fuqi ka paraparë mundësinë e atakimit të vendimeve të gjykatës së shkallës së parë edhe për pretendime të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, ashtu siç edhe ka vepruar tashmë përfaqësuesi i paditësit.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/27/24, me datë 29.11.2024

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë